



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



**RREGULLORE NR. 05/2016
PËR LICENCIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE
TË UJIT NË KOSOVË**

Nëntor 2016

PËRMBAJTJA

KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	1
Neni 1: Qëllimi	1
Neni 2: Fushëveprimi	1
Neni 3: Përkufizimet	1
Neni 4: Aktivitetet e licencuara	3
KREU II: PROCEDURAT PËR LËSHIMIN, NDRYSHIMIN DHE PËRTRITJEN E LICENCAVE PËR SHËRBIME	3
Neni 5: Autoriteti	3
Neni 6: Taksa për aplikim	3
Neni 7: Aplikimi për licencim	4
Neni 8: Procedura për shqyrtimin e aplikacioneve	4
Neni 9: Lëshimi dhe kohëzgjatja e licencës për shërbime	5
Neni 10: Përmbajtja e licencës për shërbime	6
Neni 11: Ndryshimi i licencës për shërbime	6
Neni 12: Përtritja e licencës për shërbime	6
Neni 13: Heqja dorë nga licenca për shërbime	7
Neni 14: Ndërprerja e licencës për shërbime	7
KREU III: KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR SHËRBIME	7
Neni 15: Kriteret e përgjithshme për dhënien e licencës për shërbime	7
Neni 16: Kriteret e veçanta për dhënien e licencës për shërbime	8
KREU IV: KUSHTET E LICENCËS PËR SHËRBIME DHE MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË TYRE	8
Neni 17: Obligimet e përgjithshme operative të të licencuarit	8
Neni 18: Obligimet financiare nga licencimi	9
Neni 19: Obligimet raportuese të të licencuarit	9
KREU V: DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE APELIMI	10
Neni 20: Rastet e shkeljeve	10
Neni 21: Masat sanksionuese	10
Neni 22: Apelimi kundër vendimeve të Autoritetit	10
Neni 23: Gjuhët	11
Neni 24: Dispozitat shfuqizuese	11
Neni 25: Hyrja në fuqi	11
SHTOJCA 1: APLIKACIONI PËR LICENCIM	12
SHTOJCA 2: LICENCA (KUSHTET E LICENCËS)	22

Në mbështetje të nenit 4, nënparagrafi 3.6, nenit 15, nenit 16, nenit 17 dhe nenit 18, të Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/14 Janar 2016, Drejtori i Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit (Autoriteti) nxjerr:

RREGULLORE NR.05/2016 PËR LICENCIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT

KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë procedurat, kriteret dhe kushtet për licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit në Republikën e Kosovës.

Neni 2: Fushëveprimi

1. Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (tash e tutje Autoriteti), duke zhvilluar të drejtat, obligimet dhe kushtet e licencës për shërbime, ka për qëllim që të obligojë dhe të stimulojë ofruesit e shërbimeve të ujit të veprojnë në atë mënyrë që të i arrijnë të gjitha objektivat që përcaktohen me licencë të shërbimeve.
2. Për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Autoriteti mban përgjegjësinë:
 - 2.1. të lëshojë, të ndryshojë, të pezullojë, apo të ndërpresë licencat për shërbime;
 - 2.2. të mbikëqyrë dhe të kontrollojë pajtueshmërinë me kushtet e licencës për shërbime.

Neni 3: Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Aplikues** - çdo person që aplikon për një procedim sipas kësaj Rregullore.
 - 1.2. **Autoriteti** - Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë;

- 1.3. **Drejtues (menaxher) teknik** - një individ me aftësitë e duhura për drejtimin teknik të aplikuesit/ofruesit të shërbimeve, i cili përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti;
- 1.4. **Licencë e shërbimit** - leja e lëshuar nga Autoriteti me të cilën jepet autorizimi për ofrimin e shërbimeve të ujit;
- 1.5. **I licencuar** - personi që mban një licencë të dhënë nga Autoriteti për të ofruar shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;
- 1.6. **Marrëveshje e shërbimit** - marrëveshja e nënshkruar nga Komuna dhe Ofruesit e shërbimeve nën kontrollimin dhe mbikqyrjen e Autoritetit, për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura brenda Komunës së veçantë, në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe obligimet e të dy palëve;
- 1.7. **Ofruesi i shërbimeve** - çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;
- 1.8. **Person** - person fizik apo juridik i cili mund të jetë publik apo privat;
- 1.9. **Standard i shërbimeve** - standardet e shërbimit që zbatohen për atë shërbim në përputhje me legjislacionin aktual;
- 1.10. **Shërbimet e kanalizimit** - shërbimet në infrastrukturën fizike të cilat shërbejnë për të përcjellur ujërat e ndotura;
- 1.11. **Shërbimet e ujësjellësit** - marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për atë qëllim;
- 1.12. **Shërbimet e ujërave të ndotura** - grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- 1.13. **Shërbimet e ujit** - shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizimi i ujit me shumicë;
- 1.14. **Shërbimet e ujit, me shumicë, të pa përpunuar** - shërbim i ujit të mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i papërpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.15. **Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar** - shërbim për ujin e mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.16. **Zona e shërbimit** - rajoni ose komunat në të cilën ofruesi relevant i shërbimeve duhet të ofrojë shërbimet e tij në bazë të licencës së shërbimit.

Neni 4: Aktivitetet e licencuara

1. Sipas nenit 4, paragrafi 3.1, të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti ka kompetencë për licencimin e ofruesve të shërbimeve të mëposhtme:
 - 1.1. Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit
 - 1.2. Kategoria B: Shërbimet e kanalizimit
 - 1.3. Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura
 - 1.4. Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar
 - 1.5. Kategoria E: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar
2. Asnjë ofrues i shërbimeve nuk mund të kryej aktivitete në sektorin e shërbimeve të ujit, të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse nuk është pajisur me licencë të shërbimit të lëshuar nga Autoriteti.
3. Licencimi i ofruesve të shërbimeve për Kategoritë D dhe E zbatohet te ofrimi i ujit me shumicë ofruesve të licencuar të shërbimit me ujë nga Autoriteti. Kjo nuk zbatohet për ujin me shumicë i cili i sigurohet palëve tjera.
4. Licencimi i aktiviteteve të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni do të bazohet në kriteret që janë jodiskriminuese, publike dhe transparente.

KREU II: PROCEDURAT PËR LËSHIMIN, NDRYSHIMIN DHE PËRTRITJEN E LICENCAVE PËR SHËRBIME

Neni 5: Autoriteti

1. Autoriteti ka kompetenca që të pranojë dhe të shqyrtojë të gjitha aplikacionet për licencim dhe të sigurojë që aplikacionet e tilla do të shqyrtohen në mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese.
2. Autoriteti ka kompetenca të lëshojë, refuzojë apo revokojë licencat për shërbime, të i monitorojë, inspektojë dhe të i mbikëqyrë aktivitetet e licencuara, si dhe të kërkojë nga të licencuarit që të raportojnë për kryerjen e këtyre aktiviteteve. Raportimi nga ofruesit e licencuar të shërbimeve do të bëhet sipas udhëzimeve të Autoritetit të nxjerrura kohë pas kohe.

Neni 6: Taksa për aplikim

1. Aplikuesi i paguan Autoritetit taksën e pakthyeshme, në vlerën e përcaktuar nga Autoriteti në Udhëzimin Administrativ përkatës, për paraqitjen e aplikacionit, në ditën kur aplikacioni për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime i është dorëzuar Autoritetit.
2. Pagesa kryhet përmes dërgimit të mjeteve monetare në llogarinë bankare të Autoritetit.

Neni 7: Aplikimi për licencim

1. Çdo person që plotëson kërkesat e Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit ka të drejtë të aplikojë për një licencë për shërbime që lëshohet nga Autoriteti.
2. Aplikacioni për licencim përfshinë (i) kërkesën për licencim; (ii) formularin me të dhënat bazë për licencim; si dhe (iii) listën e dokumenteve të bashkangjitura. Forma e aplikacionit gjendet në Shtojcën 1 të kësaj Rregullore.
3. Në rast se ndonjë dokument/dëshmi është nxjerrë në ndonjë gjuhë tjetër, aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentin e përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe të vërtetuar nga noteri.
4. Para se të dorëzohet tek Autoriteti, aplikacioni për licencë të shërbimeve duhet të aprovohet nga organi më i lartë drejtues i aplikuesit, i cili organ e autorizon personin ligjor që do të merret me procesin e licencimit.
5. Aplikuesi duhet të dorëzojë në Autoritet aplikacionin në tri (3) kopje të shtypura (një original dhe dy kopje) dhe elektronike në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës.
6. Aplikacioni për licencim dërgohet, zyrtarisht, në adresën postare dhe elektronike të Autoritetit. Dokumentet e kërkuara në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni duhet të jenë original ose kopje e vërtetuar nga noteri. Në aplikacion shënohet adresa e saktë për komunikim në mes të aplikuesit dhe Autoritetit.
7. Të gjithë aplikuesit për licencim do të paguajnë taksën administrative për aplikim/shqyrtim të aplikacionit, në momentin e dorëzimit të aplikacionit, sipas nenet 6 të kësaj Rregullore.
8. Taksa e paguar nga aplikuesi për shqyrtim të aplikacionit nuk kthehet edhe në rastet e refuzimit të aplikacionit.

Neni 8: Procedura për shqyrtimin e aplikacioneve

1. Autoriteti i'a konfirmon aplikuesit pranimin e aplikacionit si dhe pagesën e bërë për aplikim brenda pesë (5) ditëve të punës.
2. Nëse aplikacioni i dorëzuar konsiderohet i pakompletuar, Autoriteti do të kërkojë nga aplikuesi të ofrojë informatat e nevojshme shtesë për kompletim të aplikacionit, (siç kërkohen në Shtojcën 1 të kësaj Rregullore) brenda periudhës së specifikuar kohore.
3. Në rast se aplikacioni dhe dokumentet shtesë nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore, Autoriteti do të kërkojë nga aplikuesi të korrigjojë me shkrim aplikacionin e tij brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës.

4. Nëse aplikuesi nuk e korrighon aplikacionin e tij, ose nuk i dorëzon dëshmitë që mungojnë brenda periudhës së përcaktuar, Autoriteti do të vendosë mbi aplikacionin, bazuar në dokumentet ekzistuese dhe informatat e ofruara dhe do të informojë aplikuesin me shkrim për vendimin e tij.
5. Autoriteti do të shqyrtojë aplikacionin me të gjitha dokumentacionet e bashkangjitura brenda katërdhjetë e pesë (45) ditëve të punës pas pranimit të aplikacionit. Vendimi lidhur me aplikacionin nxirret pas këtij afati me kusht që të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara për të marrë vendimin i janë sjellur nga aplikuesi.

Neni 9: Lëshimi dhe kohëzgjatja e licencës për shërbime

1. Autoriteti merr vendim për lëshimin e licencës për shërbime në rast se aplikuesi i plotëson të gjitha kriteret të specifikuar në nenin 15 të kësaj Rregullore, si dhe ka paraqitur të gjitha informacionet e kërkuara të specifikuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregullore.
2. Autoriteti mund të refuzojë lëshimin e licencës për shërbime, pa njoftim paraprak, për shkak të mos-dorëzimit të informacioneve të domosdoshme ose në rast të mos-plotësimit të kriterëve.
3. Nëse Autoriteti vendos që të i'a refuzojë ose të mos i'a përtërijë licencën për shërbime ndonjë aplikuesi/ofruesi të shërbimeve ai e njofton atë, me vendim të shkruar (përfshirë edhe arsytimin) brenda dhjetë (10) ditëve të punës.
4. Kohëzgjatja e licencës për shërbime është përcaktuar në nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i cili ka përcaktuar periudhën e licencës për shërbime që do të aplikohet ndaj ofruesve të shërbimeve. Duke i referuar Ligjit në fjalë licencat për shërbime lëshohen për periudhën jo më të shkurt se një (1) vit dhe jo më të gjatë se dhjetë (10) vjet.
5. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencave për shërbime të lëshuara nga Autoriteti për kategoritë e parashikuara në licencën për shërbime do të përcaktohet nga Autoriteti me një vendim të posaçëm, varësisht nga rrethanat, por që do të jetë jo më gjatë se për dhjetë (10) vjet.
6. Kohëzgjatja e çdo licence për shërbime mund të vazhdohet për një periudhë kohore që nuk e tejkalon periudhën relevante kohore të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, duke nënkuptuar që i licencuari arrin të i plotësojë të gjitha kushtet dhe detyrimet e licencës për shërbime dhe të ketë parashtruar një kërkesë me shkrim për vazhdimin e licencës aktuale për shërbime.

Neni 10: Përmbajtja e licencës për shërbime

1. Licenca për shërbime e lëshuar nga Autoriteti përbëhet nga: (i) çertifikata e licencimit; dhe (ii) dokumenti i kushteve të licencimit.
2. Përmbajtja e detajzuar e licencës për shërbime, përfshirë edhe kushtet për licencim, është siguruar në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore.

Neni 11: Ndryshimi i licencës për shërbime

1. Në përgjigje të çdo kërkesë të të licencuarit ose me iniciativën e vet, Autoriteti mund të ndryshojë kushtet dhe kriteret e një licence për shërbime të lëshuar nga Autoriteti.
2. Autoriteti mund të vendos për ndryshimin e licencës kur ka ndryshime:
 - 2.1. të rrethanave të lëshimit të licencës për shërbime (ndryshimet në ligje apo rregullore që atakojnë kushtet e licencimit);
 - 2.2. teknike ose financiare që bëjnë të pamundur plotësimin e pjesëshëm ose të plotë të kushteve të vendosura për licencim;
 - 2.3. në strukturën e të licencuarit duke përfshirë ndarjen, bashkimin ose transformimin në një person tjetër;
 - 2.4. të personave përgjegjës përfshirë drejtorët jo-ekzekutiv dhe ekzekutiv të Bordit të Drejtorëve;
 - 2.5. të personit në pozitën e drejtuesit ose menaxherit teknik;
 - 2.6. në zonën e shërbimit e që është në pajtim me Planin e konsolidimit (regjionalizimit) të aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe Autoriteti;
 - 2.7. në emërtim, adresë apo në të dhënat tjera të të licencuarit.
3. Kur Autoriteti vendos të ndryshojë një licencë për shërbime, duhet të i lëshojë të licencuarit një licencë për shërbime me përmbajtje të ndryshuar, duke shfuqizuar pjesët e ndryshuara të licencës së mëparshme.
4. Në rastin e ndryshimit të licencës për shërbime Autoriteti zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin e parë.

Neni 12: Përritja e licencës për shërbime

1. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë nga Autoriteti përritjen e licencës së tij për shërbime vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet në vijim:
 - 1.1. nëse licenca për shërbime parasheh përritjen;
 - 1.2. nëse ofruesi i shërbimeve i është përmbajtur kushteve të licencës për shërbime në të gjitha aspektet materiale dhe
 - 1.3. nëse aplikacioni është paraqitur së paku dy (2) muaj para datës kur skadon licenca për shërbime.

2. Në rastin e përfitjes së licencës për shërbime, Autoriteti zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin e parë.

Neni 13: Heqja dorë nga licenca për shërbime

Ofruesi i shërbimeve mund të heq dorë nga licenca për shërbime duke e njoftuar me shkrim Autoritetin gjashtë (6) muaj më herët.

Neni 14: Ndërprerja e licencës për shërbime

1. Licenca për shërbime duhet të ndërpritet në:
 - 1.1. ditën e fundit të periudhës për të cilën është lëshuar; ose
 - 1.2. datën në të cilën licenca për shërbime është revokuar nga Autoriteti; ose
 - 1.3. datën në të cilën është hequr dorë nga licenca për shërbime.

KREU III: KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR SHËRBIME

Neni 15: Kriteret e përgjithshme për dhënie e licencës për shërbime

1. Në pajtim me nenin 17, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti përcakton kriteret e përgjithshme që do të plotësohen nga aplikuesi në mënyrë që të i lëshohet apo përtërihet licenca për shërbime.
2. Aplikuesit, që ka aplikuar për marrjen e licencës për shërbime, mund të i lëshohet ose përtrihet licenca për shërbime, nëse Autoriteti ka vlerësuar se ai, përveç të tjerash, ka përmbushur kriteret e përgjithshme si në vijim:
 - 2.1. është e regjistruar si kompani që ka si aktivitetet primar furnizimin me shërbime të ujit për një zonë të shërbimit, të përcaktuar me politikat dhe planet e Qeverisë për konsolidimin e ofruesve të shërbimeve;
 - 2.2. posedon kapacitete profesionale dhe resurse adekuate menaxhuese, operative dhe teknike për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sipas standardeve teknike dhe komerciale të shërbimeve;
 - 2.3. ka një drejtues ose menaxher (një nivel më i ulët se drejtuesi) teknik të kualifikuar me diplomë universitare në degën e inxhinierisë hidroteknike, që posedon një përvojë pune jo më pak se pesë (5) vjet në këtë sektor, dhe të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;
 - 2.4. ka qëndrueshmëri financiare;
 - 2.5. i është përmbajtur kushteve të licencës së shërbimit (vlen për rastet e përtrirjes së licencës);

- 2.6. kanë siguruar të gjitha lejet, pëlqimet, autorizimet e nevojshme nga autoritetet përkatëse.

Neni 16: Kriteret e veçanta për dhënien e licencës për shërbime

1. Aplikuesit, që ka aplikuar për marrjen e licencës për shërbime, mund të i lëshohet licenca nëse Autoriteti ka vlerësuar se ai ka përmbushur, përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 15 të kësaj Rregullore, edhe kriteret e veçanta si në vijim:
 - 1.1. ka siguruar fakte që stabilimentet të cilat përdoren për kryerjen e aktivitetit i plotësojnë kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe të mjedisit;
 - 1.2. nuk është në paaftësi të pagimit të obligimeve financiare dhe nuk është në proces të likuidimit apo të falimentimit;
 - 1.3. nuk i është revokuar licenca për të njëjtin aktivitet brenda tre (3) viteve përpara datës së parashtrimit të aplikacionit;
 - 1.4. përdorë teknologjinë moderne për kryerjen e aktiviteteve dhe monitorimin e tyre si dhe për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave;
 - 1.5. dëshmon sigurimin e mjaftueshëm të lëndës së parë (ujit);
 - 1.6. posedon pajisje matëse të instaluar në pikat e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit;
 - 1.7. posedon sistem efikas për leximin e ujëmatësve me qëllim të faturimit të drejtë;
 - 1.8. posedon sistem efikas të menaxhimit të ankesave/kërkesave të konsumatorëve.

KREU IV: KUSHTET E LICENCËS PËR SHËRBIME DHE MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË TYRE

Neni 17: Obligimet e përgjithshme operative të të licencuarit

1. I licencuari është i obliguar që gjatë gjithë kohëzgjatjes së licencës së shërbimit të:
 - 1.1. zbatojë legjislacionin në fuqi në Kosovë, si dhe rregulloret, procedurat dhe metodikat e aprovuara nga Autoriteti;
 - 1.2. furnizojë me ujë konsumatorët e tij në përputhje me standardet teknike të miratuara nga Autoriteti;
 - 1.3. mirëmbajë shërbimet në nivel të standardeve minimale të shërbimeve të specifikuar në Rregulloren përkatëse të lëshuar nga Autoriteti apo në 'marrëveshjen për përjashtimin e standardeve' nëse kjo e fundit është nënshkruar në mes të Autoritetit dhe ofruesit të shërbimeve;
 - 1.4. zbatojë tarifat për kategoritë e shërbimit të aprovuara nga Autoriteti;
 - 1.5. faturojë të gjithë konsumatorët të cilëve i'u ofrohen shërbimet;
 - 1.6. përdorë të gjitha mjetet ligjore për të siguruar financimin e veprimtarive të licencuara;
 - 1.7. mirëmbajë qëndrueshmërinë financiare;
 - 1.8. mirëmbajë kapacitetet menaxheriale dhe operative-teknike në nivelin adekuat;

- 1.9. mirëmbajtje dhe përtirijë lejet dhe aprovimet e kërkuara nga agjencitë tjera sipas kërkesës fillestare për licencim.
2. I licencuari do të njoftojë Autoritetin brenda dhjetë (10) ditëve të punës për çdo ndryshim të:
 - 2.1. emërtimit dhe adresës;
 - 2.2. drejtorëve të Bordit të Drejtorëve si dhe drejtuesit (menaxherit) teknik;
 - 2.3. kushteve të licencës;
 - 2.4. zonës së shërbimit.
3. Kur drejtuesi ose menaxheri teknik është dorëhequr, përjashtuar, ose i ka kaluar kontrata, i licencuari obligohet që brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike të paraqesin njoftimin në Autoritet së bashku me kërkesën dhe dokumentet përkatëse për drejtuesin e ri teknik.
4. I licencuari ndalohet të transferojë licencën për shërbime një pale tjetër pa pëlqimin me shkrim të Autoritetit.
5. I licencuari ndalohet të bëjë marrëveshje me një person tjetër për shitjen e ujit të pijshëm për qëllime tregtare, pa pëlqimin e Autoritetit.

Neni 18: Obligimet financiare nga licencimi

1. Ofruesi i shërbimeve i paguan Autoritetit taksën vjetore të licencimit deri në një pikë pesë përqind (1.5%) e bruto faturimit vjetor të raportuar në pasqyrën e të ardhurave të saja për vitin paraprak.
2. Shuma e caktuar për të u paguar në emër të taksës vjetore të licencimit përcaktohet nga Autoriteti, çdo vit, përmes Udhëzimit Administrativ përkatës. Shuma totale e të hyrave nga taksa vjetore është e barabartë me shumën e buxhetit të Autoritetit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.
3. Taksa vjetore e licencimit duhet paguar nga ofruesi i shërbimeve në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta gjatë vitit. Kësti i parë duhet të paguhet në ditën e parë të muajit kalendarik pas muajit në të cilin licenca për shërbime i është lëshuar ose përtëritur ofruesit të shërbimeve, kurse secili nga këstet e radhës duhet të paguhet në ditën e parë të secilit muaj pasues kalendarik.
4. Pagesa do të kryhet përmes dërgimit të mjeteve monetare në llogarinë bankare të Autoritetit.

Neni 19: Obligimet raportuese të të licencuarit

1. Autoriteti kontrollon zbatimin e kushteve të licencës nga i licencuari dhe e vlerëson nivelin e zbatueshmërinë së tyre.
2. Autoriteti monitoron përmbushjen e aktiviteteve të licencuara, bazuar në të dhënat

që i licencuari ka raportuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

3. I licencuari obligohet të bashkëpunojë me Autoritetin në raportimin e të gjitha të dhënave të kërkuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.
4. Autoriteti mund të kryejë inspektime që të sigurohet për besueshmërisë e të dhënave të raportuara. Inspektimi kryhet sipas Rregullores nr. 04/2016, të lëshuar nga Autoriteti.

KREU V: DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE APELIMI

Neni 20: Rastet e shkeljeve

1. Nëse pas kryerjes së hetimeve të arsyeshme, Autoriteti vie në përfundim se i licencuari nuk ka zbatuar kushtet e licencës, i njëjti e informon me shkrim të licencuarin.
2. I licencuari obligohet të i parashtrojë një deklaratë me shkrim Autoritetit për çdo shkelje të kushteve të licencës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga momenti kur kjo shkelje i bëhet e njohur zyrtarisht me shkrim nga Autoriteti.
3. Nëse shpjegimet e siguruara nga i licencuari nuk arsyetohen nga Autoriteti, ky i fundit do të marrë masa me qëllim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Neni 21: Masat sanksionuese

1. Nëse i licencuari bën shkelje të dispozitave ligjore të kësaj Rregullore dhe licencës së lëshuara nga Autoriteti, ndaj tij do të shqiptohen masat administrative dhe gjobat, në përputhje me legjislacionin në fuqi, që përfshijnë:
 - 1.1 pezullimin e licencës, nëse i licencuari:
 - 1.1.1 nuk i përgjigjet legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga Autoriteti;
 - 1.1.2 shkel kushtet e licencës;
 - 1.1.3 nuk paraqitet brenda afatit të caktuar nga Autoriteti për ndryshimin e kushteve të licencës.
 - 1.2 revokimin e licencës, nëse i licencuari gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij bën shkelje të rënda të kushteve të licencës.

Neni 22: Apeli kundër vendimeve të Autoritetit

Kundër çdo vendimi të Autoritetit, lidhur me licencimin, i licencuari mund të i parashtrojë ankesë komisionit shqyrtues në pajtim me nenin 41, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

KREU VI: TË NDRYSHME

Neni 23: Gjuhët

- 1 Kjo Rregullore nxjerret dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- 2 Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve në të cilat është lëshuar kjo Rregullore, versioni në gjuhën Shqipe do të mbizotërojë.

Neni 24: Dispozitat shfuqizuese

- 1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë (nr. R-01/U&K).
- 2 Çdo licencë e lëshuara nga Autoriteti do të mbetet në fuqi deri në kohën e skadimit të afatit të tyre, duke respektuar kushtet e licencës përkatëse. Ndërsa, në rast të nevojës për modifikim të licencave në fuqi, Autoriteti do të respektojë këtë Rregullore.

Neni 25: Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit.

Raif Preteni

Drejtor

SHTOJCA 1: APLIKACIONI PËR LICENCIM

KËRKESË PËR LICENCIM

[Emërtimi i aplikuesit]

[Adresa e plotë e aplikuesit]

[Nr. tel/e-mail i aplikuesit]

Aplikojmë për:

[shërbimet e kërkuara shenjzohen me 'X']

1. Licencim për herë të parë/përtrirje

1.1. Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit

1.2. Kategoria B: Shërbimet e kanalizimit

1.3. Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura

1.4. Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar

1.5. Kategoria E: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar

2. Ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të:

[shëno ndryshimet për të cilat aplikohet]

Deklarata e personit të autorizuar:

Nën përgjegjësinë time të plotë ligjore, deklaroj se të dhënat, dëshmitë dhe informacionet e paraqitura në formularin e aplikimit dhe në dokumentet e bashkangjitura, në vijim, janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me çdo kërkesë të parashikuar në Rregulloren për Licencim, të lëshuar nga Autoriteti rregullator i shërbimeve të ujit.

Poashtu, me marrjen e licencës, deklaroj në përgjegjësinë time, që do të ndjek me përpikmëri zbatimin e akteve ligjore, akteve nënligjore të nxjerra nga Autoriteti si dhe kushtet e licencës.

[Emri & mbiemri dhe pozita e punës e personit të autorizuar]

Nënshkrimi

FORMULARËT ME TË DHËNAT BAZË PËR LICENCIM

FORMULARI PËR KATEGORINË 'A'

1. Zona e shërbimit (territori dhe popullata e shërbyer):

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit				
Komunat [Emërtimi i komunave që do të ju ofrohen shërbimet në kohën e marrjes së licencës]	Zona urbane (qyteti) dhe zonat rurale (fshatrat) [Emërtimi i fshatrave që do të ju ofrohen shërbimet në kohën e marrjes së licencës (kolona A) si dhe numri i popullatës që shërbehet (kolona B). Të listohen fshatrat brenda komunave përkatëse]		Kërkesa e vlerësuar për shërbimet e ujit [Shëno sasinë e vlerësuar të kërkesës për furnizim me ujë, m ³ /vit. Për biznese dhe institucioni kërkesa të shndërrohet në p.e.]	Ofrimi i furnizimit me shërbime të ujit [Shëno sasinë e ofruar të furnizimit me ujë, m ³ /vit]
	A	B		
<i>Gjakovë¹</i>	<i>Qyteti</i>	<i>70,000</i>	<i>3,832,500</i>	<i>3,800,000</i>
	<i>Bardhaniq</i>	<i>2,500</i>		
	<i>Batusha</i>	<i>3,000</i>		
	<i>etj.</i>			
<i>Rahovec</i>				
	<i>Qyteti</i>	<i>40,000</i>		
	<i>Zoqisht</i>			
	<i>Opterushë</i>			
	<i>etj.</i>			
<i>Prizren</i>				
	<i>Lubizhdë</i>			
	<i>Krushë</i>			
	<i>etj.</i>			

2. Burimet e ujit:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit				
Emërtimi	Vendndodhja	Lloji [pus, burim, liqe, lum]	Vëllimi i kaptimit, m ³ /vit	Kapaciteti shfrytëzues, m ³ /vit

¹ Shënimet me ngjyrë të kuqe shërbejnë si shembuj.

3. Trajtimi i ujit:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit				
Emërtimi i Impiantit	Vendndodhja	Lloji i trajtimit (fizik, biologjik, kimik)	Kapaciteti maksimal, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit
Totali				

4. Objektet për rezervimin e ujit të trajtuar:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit		
Emërtimi	Vendndodhja	Kapaciteti rezervues, m3
Totali		

5. Cilësia e ujit të trajtuar:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit		
Emërtimi i Impiantit	Lloji i analizave	% e përmbushjes së standardeve [analizat e verifikuara nga IKSHKP]
	Analizat bakteriologjike	
	Analizat kimike	

6. Personeli:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË 'B'

I. Zona e shërbimit:

Kategoria B: Shërbimet e kanalizimit	
Komunat: <i>[Emërtimi i komunave që do të ju ofrohen shërbimet në kohën e marrjes së licencës]</i>	Zona urbane (qyteti) dhe zonat rurale (fshatrat): <i>[Emërtimi i fshatrave që do të ju ofrohen shërbimet në kohën e marrjes së licencës (kolona A). Të listohen fshatrat brenda komunave përkatëse]</i>

II. Personeli:

Kategoria B: Shërbimet e kanalizimit
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË 'C'

I. Zona e shërbimit:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura	
Komunat <i>[Emërtimi i komunave, ujërat e ndotura të së cilës do të trajtohen]</i>	Zona urbane (qyteti) dhe zonat rurale (fshatrat) <i>[Emërtimi i fshatrave, ujërat e ndotura të së cilës do të trajtohen. Të listohen fshatrat brenda komunave përkatëse]</i>

II. Trajtimi i ujërave të ndotura:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura			
Emërtimi i Impiantit	Vendndodhja	Lloji i trajtimit (fizik, biologjik, kimik)	Kapaciteti maksimal, m ³ /vit

III. Cilësia e ujërave të ndotura të trajtuara:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura		
Emërtimi i Impiantit	Lloji i parametrave	% e përmbushjes së parametrit <i>[analizat e verifikuara nga MMPH]</i>
	Nevoja biokimike për oksigjen (eng. BOD)	
	Nevoja kimike për oksigjen (eng. COD)	

IV. Personeli:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË 'D'

I. Entiteti përfitues:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar		
Emërtimi, Vendndodhja/Adresa	Kërkesa e vlerësuar për ujë, m3/vit	Validiteti i kontratës <i>[shëno datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës]</i>

II. Burimet e ujit:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar				
Emërtimi	Vendndodhja	Lloji <i>[pus, burim, liqe, lum]</i>	Vëllimi i kaptimit, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit

III. Objektet për rezervimin e ujit, me shumicë, të papërpunuar:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar		
Emërtimi	Vendndodhja	Kapaciteti rezervues, m3
Totali		

IV. Personeli:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË 'E'

I. Entiteti përfitues:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar		
Emërtimi, Vendndodhja/Adresa	Kërkesa e vlerësuar për ujë, m3/vit	Validiteti i kontratës <i>[shëno datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës]</i>

II. Burimet e ujit:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar				
Emërtimi	Vendndodhja	Lloji <i>[pus, burim, liqe, lum]</i>	Vëllimi i kaptimit, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit

III. Trajtimi i ujit:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar				
Emërtimi i Impiantit	Vendndodhja	Lloji i trajtimit <i>[fizik, biologjik, kimik]</i>	Kapaciteti maksimal, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit
Totali				

IV. Objektet për rezervimin e ujit, me shumicë, të përpunuar:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar		
Emërtimi	Vendndodhja	Kapaciteti rezervues, m3
Totali		

V. Cilësia e ujit, me shumicë, të përpunuar:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar		
Emërtimi i Impiantit	Lloji i analizave	% e përmbushjes së standardeve <i>[analizat e bëra nga IKSHPK]</i>
	Analizat bakteriologjike	
	Analizat kimike	

VI. Personeli:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

LISTA E DOKUMENTEVE TË BASHKANGJITURA

1. Certifikata e regjistrimit të aplikuesit si organizatë biznesore, e lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e organizatave biznesore;
2. Dokumenti i regjistrimit në organet tatimore;
3. Dëshmia e fundit në lidhje me kushtet higjieno – sanitare, lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Vetëmbrojtjes/Inspektorati Sanitar i Kosovës;
4. Letër rekomanduese nga IKSHPK për (mos) lejimin e ujit për konsum njerëzor, të funizuar nga ofruesi i shërbimeve;
5. Leja e mjedisit për shfrytëzimin e burimeve të ujit;
6. Leja e mjedisit për shkarkimin e ujërave të ndotura;
7. Marrëveshja për shërbime e nënshkruar (apo në procedim e sipër) nga komunat përkatëse dhe ofruesi i shërbimeve;
8. CV e drejtuesit ose menaxherit teknik;
9. Dokumenti i kualifikimit të drejtuesit ose menaxherit teknik;
10. Dëshmia e penaltetit për drejtuesin ose menaxherin teknik;
11. Pasqyrat financiare vjetore, të audituara, për dy (2) vitet e fundit;
12. Plani i biznesit (3 vjeçar);
13. Hartat (skemat) e informacioneve gjeografike që përfshijnë: (i) zonën e shërbimit (përfshirë ndaras pjesët urbane dhe rurale), (ii) objektet e trajtimit (dhe rezervimit) të ujit/ujërave të ndotura; (iii) burimet e ujit të shfrytëzuar; si dhe (iv) rrjeti kryesor dhe shpërndarës;
14. Autorizimi nga organi më i lartë i udhëheqjes (Bordi i Drejtorëve) për personin, të cilit i është dhënë e drejta për të kryer të gjitha veprimtaritë për aplikim të marrjes së licencës;
Shablloni në vijim:

AUTORIZIMI I BORDIT TË DREJTORËVE

Data: dita-muaji-viti

Nga: *[emri i aplikuesit]*

Për: Autoritetin rregullator të shërbimeve të ujit (Autoriteti)

Lënda: Autorizimi i Bordit të Drejtorëve për aplikacionin për licencë të shërbimeve

Bordi i Drejtorëve të *[emri i aplikuesit]* konfirmon se Drejtori Ekzekutiv *[emri dhe mbiemri]* autorizohet, në emër të *[emri i aplikuesit]* të aplikojë për licencë të shërbimeve në Autoritet.

Me respekt,

[nënshkrimi]

[emri dhe mbiemri]

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

SHTOJCA 2: LICENCA (KUSHTET E LICENCËS)



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



LICENCË PËR SHËRBIME USLUŽNOJ DOZVOLI SERVICE LICENSE

I Licencuari:
Licencirani
Licensee

Numri i Licencës:
Broj Dozvole
License Number

Adresa e të Licencuarit:
Adresa Licenciranog
Address of Licensee

Aktivitetet e licencuara:
Licencirane aktivinosti
Licensed activities

Data e lëshimit:
Datum izdavanje
Date of issue

Zona e shërbimit: Komunat/Opštine/Municipalities
Uslužna Zona:
Service Area:

Kushtet e përgjithshme:

Kjo Licencës për shërbime lëshohet në përputhje me Ligjin Nr.05/L-042. Kushtet e licencës, sipas tekstit të bashkangjitur, janë pjesë e pandarë e kësaj Licence. I licensuari në ushtrimin e aktivitetit të tij, vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara të Licencës.

Opšti uslovi:

Ova usluge dozvola izdata u skladu sa Zakonom br.05 / L-042 . Uslovi dozvole, prema tekstu u prilogu, čine sastavni deo ove Licence. Licencirani u vršenju svoje delatnosti, deluje u skladu sa uslovima postovljene Licence.

General terms and conditions:

This service license is issued in accordance with Law No.05 / L-042. Terms of the License, according to the text attached, are an integral part of this License. Licensee in performing its activity, acts in accordance with the conditions set in this License.

Prishtinë, d/m/v
[vula e Autoritetit]

Në emër të Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit
U ime Regulatorni Autoritet za Usluge Vode
On behalf of Water Services Regulatory Authority

Raif Preteni, Drejtor



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



KUSHTET E LICENCËS PËR SHËRBIMET E

[Shëno njërën, disa apo të gjitha shërbimet në vijim:

Shërbimet e ujësjellësit

Shërbimet e kanalizimit

Shërbimet e ujërave të ndotura

Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar

Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar]

I licencuari: *[shëno emrin e të licencuarit]*

Nr. i Licencës për shërbime: *[shëno numrin]*

Muaji, viti

REPUBLIKA E KOSOVËS

Ligji nr. 05/I-042 për Rregullimin e shërbimeve të ujit

Rregullore nr. 05/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit

LICENCË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

AUTORITETI RREGULLATOR I SHËRBIMEVE TË UJIT (tash e tutje: Autoriteti) në pajtim me Ligjin nr. 05/I-042 për Rregullimin e shërbimeve të ujit dhe Rregulloren nr. 05/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit, pas shqyrtimit të aplikacionit të dorëzuar nga [shëno emrin e të licencuarit] konkludon se parashtruesi i kërkesës për licencim:

1. Është organizatë e regjistruar për kryerjen e shërbimeve për të cilat ka kërkuar të licencohet;
2. Ka sjellur prova të mjaftueshme që tregon se ai ka potencial teknik dhe financiar për të ofruar shërbimet dhe për të kryer funksionet e autorizuara me licencë;
3. Ka përgatitur dhe dorëzuar një plan biznesi për ofrimin e shërbimeve me efikasitet, sipas standardeve të përcaktuara të shërbimeve, me tarifa të përballueshme për qytetarët dhe të qëndrueshme në rast të rritjes së kërkesës për konsumatorët ekzistues.

Autoriteti pas shqyrtimit të fakteve dhe duke vepruar në bazë të kompetencave të saja që burojnë nga legjislacioni i cituar më sipër, i lëshon Licencë [shëno emrin e të licencuarit] për aktivitetet [shëno aktivitetet e licencuara] në bazë të kushteve të specifikuara në këtë dokument.

Në emër të Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit

[nënshkrimi]

Raif Preteni, Drejtor

Neni 1: Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Autoriteti** - Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë;
 - 1.2. **Drejtuës (menaxher) teknik** - një individ me aftësitë e duhura për drejtimin teknik të aplikuesit/ofruesit të shërbimeve, i cili përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti;
 - 1.3. **Licencë e shërbimit** - leja e lëshuar nga Autoriteti me të cilën jepet autorizimi për ofrimin e shërbimit të ujit;
 - 1.4. **I licencuar** - personi që mban një licencë të dhënë nga Autoriteti për të ofruar shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;
 - 1.5. **Kategoria e konsumatorëve** - kategoria e konsumatorëve të definuar si në vijim:
 - 1.5.1. **Konsumator shtëpiak** - konsumatori i klasifikuar nga Ofruesi i shërbimeve si person i cili shfrytëzon shërbimet në banesën e tij apo saj për nevoja të amvisërisë;
 - 1.5.2. **Konsumator komercial/industrial** - personi, subjekti ligjor ose organizata afariste e klasifikuar nga Ofruesi i shërbimeve si konsumator i cili shfrytëzon shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
 - 1.5.3. **Konsumator institucional** - subjekti ligjor i klasifikuar nga Ofruesi i shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare Nr. 02/L-123;
 - 1.6. **Kontrata e shërbimit** - kontrata standarde e cila duhet të lidhet në mes të Ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorit e cila rregullon ofrimin e shërbimeve, të drejtat dhe obligimet e palëve;
 - 1.7. **Marrëveshje e shërbimit** - marrëveshja e nënshkruar nga Komuna dhe Ofruesit e shërbimeve nën kontrollimin dhe mbikqyrjen e Autoritetit, për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura brenda Komunës së veçantë, në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe obligimet e të dy palëve;
 - 1.8. **Ofruesi i shërbimeve** - çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;

- 1.9. **Person** - person fizik apo juridik i cili mund të jetë publik apo privat;
- 1.10. **Standard i shërbimeve** - standardet e shërbimit që zbatohen për atë shërbim në përputhje me legjislacionin aktual;
- 1.11. **Shërbimet e kanalizimit** - shërbimet në infrastrukturën fizike të cilat shërbejnë për të përcjellur ujërat e ndotura;
- 1.12. **Shërbimet e ujësjellësit** - marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për atë qëllim;
- 1.13. **Shërbimet e ujërave të ndotura** - grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- 1.14. **Shërbimet e ujit, me shumicë, të pa përpunuar** - shërbim i ujit të mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i papërpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.15. **Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar** - shërbim për ujin e mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.16. **Tarifa e shërbimit** - vlera, ngarkesa apo tarifa fikse të ofruesit të shërbimeve me të cilën ofruesi i shërbimeve e ngarkon konsumatorin në lidhje me ofrimin e shërbimeve;
- 1.17. **Zona e shërbimit** - rajoni ose komunat në të cilën ofruesi relevant i shërbimeve duhet të ofrojë shërbimet e tij në bazë të licencës së shërbimit.

Neni 2: Kushtet e përgjithshme

- 1. Autoriteti e lëshon këtë licencë të shërbimit për të Licencuarin në pajtim me Ligjin nr.05/L-042 për Rregullimin e shërbimeve të ujit dhe Rregulloren nr. 05/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit.
- 2. I Licencuari do të ofrojë shërbimet në tërë zonën e shërbimit sipas dokumentacionit të paraqitur në Aplikacion.
- 3. Kohëzgjatja e kësaj Licence për shërbime është pesë (5) vjet nga data e nënshkrimit të kësaj Licence.
- 4. I licencuari obligohet të njoftojë Autoritetin për çdo ndryshim të informacioneve dhe kushteve të kësaj Licence të shërbimeve në pajtim me nenin 17, paragrafi 2 dhe paragrafi 3 të Rregullores nr. 05/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit.

5. Autoriteti me iniciativën e vet dhe / ose me kërkesë të të licencuarit mund të ndryshojë këtë Licencë të shërbimeve dhe kushtet e saj, në përputhje me nenin 11 të Rregullores nr. 05/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit.
6. Kjo Licencë për shërbime nuk mund të i transferohet ndonjë pale tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit.
7. Kjo Licencë për shërbime mund të përtëritet nga Autoriteti me kërkesë të të Licencuarit, në pajtim me nenin 12 të Rregullores nr. 05/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit.
8. I Licencuari është i obligueshëm të i paguajë Autoritetit taksën vjetore të licencimit në pajtim me nenin 18 të Rregullores nr. 05/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit.

Neni 3: Obligimet e përgjithshme të të licencuarit

1. I licencuari është i obliguar që gjatë kohëzgjatjes së kësaj Licence të:
 - 1.1. zbatojë legjislacionin në fuqi, rregullat, procedurat dhe metodikat e nxjerrura nga Autoriteti;
 - 1.2. zbatojë kushtet e kësaj Licence për shërbime. Nëse gjatë kryerjes së veprimtarisë së licencuar shfaqen rrethana për të cilat i licencuari në mënyrë të arsyeshme nuk është në gjendje të kryejë veprimtaritë e specifikuar sipas kushteve të kësaj Licence për shërbime, i licencuari do të njoftojë menjëherë Autoritetin dhe do të ndjek udhëzimet e tij.
 - 1.3. ushtrojë veprimtarinë sipas kategorive të shërbimeve të përcaktuara në këtë Licencë brenda zonës së shërbimit;
 - 1.4. sigurojë cilësinë e ujit sipas standardeve të cilësisë së ujit të përcaktuara nga autoritetet vendore përkatëse;
 - 1.5. sigurojë kapacitetet financiare, teknike, dhe menaxheriale të nevojshme për ofrimin e shërbimeve në nivel të standardeve minimale të shërbimit në pajtim me Rregulloren nr. 02/2016 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit;
 - 1.6. përdorë të gjitha mjetet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të siguruar financimin e aktiviteteve të licencuara;
 - 1.7. zbatojë kushtet e kontratës të nënshkruar me konsumatorët e vet.
2. I licencuari gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk mund të bashkëpunojë me të licencuar të tjerë në dëm të konsumatorëve të ndonjërës apo të dy palëve.
3. I licencuari duhet të kryejë veprimtarinë e tij në përputhje me planet operative dhe të investimeve kapitale të aprovuara nga Autoriteti gjatë përcaktimeve tarifore.

4. I licencuari duhet të zbatojë tarifat e shërbimit të aprovuara nga Autoriteti për kategoritë e shërbimit sipas kategorive të konsumatorëve.
5. I licencuari nuk do të hyjë në asnjë marrëveshje me askë që mund të rezultojë në shkelje të kushteve të kësaj Licence për shërbime ose të ndonjë dispozite tjetër ligjore e nënligjore në fuqi.
6. I licencuari nuk ka të drejtë të bëjë marrëveshje me një person të tretë për shitjen e ujit të pijshëm me shumicë për qëllime tregtare, pa aprovimin e Autoritetit.

Neni 4: Obligimet raportuese e të licencuarit ndaj Autoritetit

1. I licencuari obligohet të bashkëpunojë me Autoritetin në raportimin e të gjitha të dhënave të kërkuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj Licence për shërbime.
2. I licencuari do të i dorëzojë Autoritetit, deri në fund të muajit Prill të çdo viti, pasqyrat financiare të audituara nga auditorët e pavarur.
3. I licencuari do të i nënshtrohet inspektimeve të organizuara kohë pas kohe nga Autoriteti për të siguruar besueshmërisë e të dhënave të raportuara nga i licencuari si dhe mirëmbajtjen e aseteve në shfrytëzim nga i licencuari.

Neni 5: Masat sanksionuese

1. Në rast se I licencuari shkel kushtet e kësaj Licence për shërbime dhe legjislacionit në fuqi si dhe aktet nënligjore të nxjerrura nga Autoriteti, ndaj të tij do të shqiptohen masat administrative dhe gjobat, në përputhje me legjislacionin në fuqi, që përfshijnë:
 - 1.1 pezullimin e licencës, nëse i licencuari:
 - 1.1.1 nuk i përgjigjet legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Autoriteti;
 - 1.1.2 shkel kushtet e licencës;
 - 1.1.3 nuk paraqitet brenda afatit të caktuar nga Autoriteti për ndryshimin e kushteve të licencës.
 - 1.2 revokimin e licencës, nëse i licencuari gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij bën shkelje të rënda të kushteve të licencës.
2. Kundër çdo vendimi të Autoritetit, lidhur me licencimin, i licencuari mund të i parashtojë ankesë komisionit shqyrtues në pajtim me nenin 41, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.